

29 shtator 2014, Prizren

KOMUNIKATE PËR MEDIA
Përfundojnë Ditët e Trashëgimisë Shpirtërore HAJDE! në Prizren

Me manifestimet e djeshme të realizuara në Sheshin Shadërvan në Prizren, u përmbyll një javë e plotë e *Ditëve të Trashëgimisë Shpirtërore*. Në ngjarjet përmbyllëse performuan vullnatërt e ShKA Agimi dhe instrumentistët e Kuartetit Pentagram, ndërsa në të njëjtën kohë të pranishmit e vizitonin mini-panairin e artizanateve dhe e shijonin ushqimin tradicional të rajonit të Prizrenit. Dita u përmbyll me ndarjen e certifikatave për pjesëmrrësit e punëtorisë pesë ditore të Filigranit, aktivitet qendror i *Ditëve të Trashëgimisë Shpirtërore HAJDE!*

Manifestimet për të kremtuar trashëgiminë jomateriale (shpirtërore) u organizuan në kuadër të projektit të përbashkët të BE/KE për Përkrahjen dhe Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë, nga 23 deri më 28 shtator 2014. *Ditët e Trashëgimisë Kulturore HAJDE!* në Prizren u organizuan nga EC Ma Ndryshe, ndërsa qëllimi i këtij aktiviteti ishte promovimi i trashëgimisë kulturore të rajonit të Prizrenit dhe nxitja e qytetarisë aktive për mbrojtjen e këtyre vlerave.

Në këtë javë kushtuar trashëgimisë jomateriale (shpirtërore) aktivitetet ishin të ndara në grupe, Punëtorja e zejes së Filigranit për të rinjtë dhe Hapësira Publike e Padukshme. Punëtorja e zejes së Filigranit kishte 12 pjesëmarrës nga Shkupi, Gjakova, Korça, Juniku, Prizreni, Prishtina e Tirana. Gjatë gjithë javës, këta të rinj kanë punuar me mjeshtrit e filigranit nga Prizreni dhe njëkohësisht kanë ndjekur një program ligjëratah dhe vizitash të trashëgimisë kulturore. Pas përfundimit të punëtorisë, secili pjesëmarrës prodhoi nga një vepër filigrani, të cilat u ekspozuan në ditën përmbyllëse të *HAJDE!*

Pjesa e dytë e aktiviteteve të *HAJDE!* u mbajt në Sheshin Shadërvan të Prizrenit dhe kishte për qëllim ekspozimin e praktikave shpirtërore të trashëgimisë në Hapësirën e Padukshme Publike të qytetit. Gjatë këtyre ditëve, në hapësirën publike u paraqitën Aziza Shefitagiq nga fshati Lubinjë e Poshtme me traditën e lashtë të pikturimit të fytyrës së nuseve nga rajoni i Zhupës, rapsodët e Malishevës me interpretimin e këngëve kreshnike dhe Ramadan Bajselmani nga Suhareka me mizhnicë (gajde) dhe fyell. Në ditën e fundit të javës *HAJDE!* performuan valltarët e ShKA Agimi nga Prizreni dhe instrumentistët e Kuartetit Pentagram, derisa në mini-panairin e artizanateve po ekspozoheshin produktet e punuara me dorë të filigranit, plisave, briskave dhe veshjeve tradicionale. Njëditë u promovua edhe gastronomia tradicionale e rajonit të Prizrenit.

Ky aktivitet është mbështetur financiarisht nga projekti i përbashkët i BE/KE për Përkrahjen dhe Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë.

Me respekt,
Valon Xhabali, koordinator i projektit
OJQ EC Ma Ndryshe